

### ***Parimi 1: Të mësuarit profesional është fokusuar në rezultatet e studentëve (jo vetëm nevojat individuale të mësuesve)***

Edukimi profesional ka si qëllim maksimizimin e të mësuarit të studentëve, në mënyrë që të gjithë studentët të arrijnë potencialin e tyre të të mësuarit. Duke përdorur burime të shumta të të dhënave për rezultatet e studentëve, edukimi profesional i mësuesve duhet të udhëhiqet nga analiza e dallimeve mes qëllimeve dhe standarteve për mësimin e studentëve dhe performancën e tyre.

### ***Parimi 2: Mësimi profesional është fokusuar dhe i përfshirë në praktikën e mësuesve (jo i shkëputur nga shkolla)***

Mësimi profesional i mësuesve duhet të jetë i fokusuar në shkollë dhe të jetë i përfshirë në punën e përditshme të mësimdhënies. Përvojat më domethënëse të të nxënit ndodhin në shkollë, ku mësuesit mund të adresojnë problemet dhe sfidat e menjëhershme të mësimit dhe mësimdhënies. Vendosja afër klasës dhe afër kolegëve, iu mundëson mësuesve të punojnë sëbashku për të identifikuar problemet , duke krijuar zgjidhje si dhe duke i zbatuar këto zgjidhje.

Me këtë nuk nënkuptojmë që përtej përvojave të mësimit në shkollë, të tilla si studimet parauniversitare ose pjesëmarrja në ëorkshope dhe seminare nuk janë të vlefshme. Mundësitë e jashtme të të mësuarit mund të plotësojnë mësimin profesional të bazuar në shkollë. Mësimi profesional duhet të jetë i bazuar jo vetëm në punën që realizojnë mësuesit në shkollë, por të pasurohet dhe njohuri jasht saj.

### ***Parimi 3: Mësimi profesional merr informacione nga kwrkimet shkencore mbi mësimdhënien dhe mësimnxënien efektive (jo vetëm i kufizuar mbi njohuritë aktuale).***

Mësimi profesional i mësuesve që përmirëson mësimnxënien e të gjithë nxënësve, përgatit mësuesit për të aplikuar në studime që lidhen me vendimmarrjen. Programet e suksesshme të mësimit profesional, fokuson mësuesit në përmbajtjen që ata shpjegojnë dhe ofrojnë njohuri të bazuara në studime mbi mënyrën e mësimit të përmbajtjes nga studentët.

Rezultatet e studimit duhet të jenë të arritshme nga mësuesit në mënyrë që të mundësohet zgjerimi i bazës së tyre të njohurive profesionale. Ky studim duhet të përfshijë informacione mbi mësimdhënien dhe mësimnxënien efektive, mënyrën se si nxënësit mësojnë një përmbajtje të veçantë, menaxhimin e klasës, vlerësimin dhe kurrikulën.

### ***Parimi 4: Mësimi profesional është bashkëpunues, që përfshin reflektime dhe reagime (jo vetëm kërkim individual)***

Mundësitë e mësimit profesional duhet të lidhen me nevojat individuale , por të organizuara

drejt zgjidhjeve bashkëpunuese të problemeve. Të organizuar në grupe, mësuesit marrin përgjegjësi kolektive për zgjidhjen e problemeve komplekse të mësimdhënies dhe të mësimnxënies, si dhe përmirësimin të rezultateve të studentëve. Grupet ndajnë njohuri, eksperiencë dhe profesionalizëm në mënyrë që të thellohet të mësuarit dhe të nxitet një kuptim i ndërsjelltë i praktikës efektive në klasë. Grupet krijojnë mundësi për të pasur reflektime, mbështetje dhe ndihmë për të ndarë pjesë të punës së përbashkët, në mënyrë të barabartë.

Reagimet konstruktive, objektive dhe komentet vepruese për praktikën e mësuesve është e rëndësishme për identifikimin e nevojave të mësuesve për të përmirësuar performancën e tij/saj dhe me qëllim hartimin e mundësive të të mësuarit profesional që adresojnë aspektet për përmirësim.

Mësuesit kompetentë, me përvojë, drejtuesit e shkollës ose një ekspert i jashtëm gjithashtu mund t'u jap mësuesve komente mbi mësimin e tyre profesional. Për shembull, komentet nga një koleg i besuar në lidhje me funksionimin e një grupi profesional mësimi ose një partneriteti mentorimi është i dobishëm për të vlerësuar efektivitetin e strategjive të tilla.

***Parimi 5: Mësimi profesional është i bazuar në prova dhe nxitur nga të dhënat për të udhëhequr përmirësimin dhe matur ndikimin e tij.***

Të dhëna nga burime të ndryshme mund të përdoren për të përcaktuar përmbajtjen e mësimin profesional të mësuesve dhe për të hartuar dhe monitoruar ndikimin e programeve të të mësuarit profesional.

Evidencat më tepër se anekdotat, duhet të mblidhen rregullisht në nivelin e studentit, mësuesit dhe shkollës për të ndihmuar në ndihmuar në fokusimin e mësimin të mësuesve. Për shembull, revistat studentore mund të analizohen për të identifikuar zona ku studentët kanë vështirësi ose për të parë përparimin e studentëve nga një muaj në tjetrin.

Të dhënat mund të përdoren për të matur dhe përmirësuar impaktin e të mësuarin profesional. Vlerësimet formuese i lejojnë mësuesit të bëjnë ribotime dhe korrigjime të programit, ndërsa vlerësimet përmbledhëse masin efektin e veprimtarive profesionale të të mësuarit dhe ndikimin e tyre në praktikën e mësuesve, njohuritë dhe mësimnxënien e nxënësve.

***Parimi 6: Të mësuarit profesional është i vazhdueshëm, i mbështetur dhe i integruar plotësisht në kulturën dhe funksionimin e sistemit – shkollave, rrjeteve, rajoneve dhe qendrës (jo episodike dhe të fragmentizuara)***

Mësimi profesional duhet të jetë i vazhdueshëm, afatgjatë dhe i vazhdueshëm. Ndryshimi domethënës dhe afatgjatë në praktikën e mësuesve nuk ndodh brenda disa javëve, por përgjatë muajve dhe viteve. Të mësuarit duke u ushtruar, reflektuar dhe përsëritur është një proces i gjatë më shumë faza.

Mësuesit kanë nevojë për mbështetje në mësimin e tyre profesional. Zgjidhja e problemeve komplekse dhe zbatimi i praktikave inovative, mund të kërkojnë ekspertizë dhe burime shtesë. Inkurajimi dhe njohja është gjithashtu thelbësore për ruajtjen e përpjekjeve pasi krijohen mënyra të reja për të realizuar diçka është e vështirë dhe shpesh e dhimbshme. Mbështetja e qëndrueshme dhe e menjëhershme cilësore është thelbësore për të siguruar përmirësimin në shkolla dhe klasa, veçanërisht kur shfaqen probleme të papritura.

***Mësimi profesional i vazhdueshëm dhe i mbështetur duhet të përfshihet në sistem. Stafet qendror dhe rajonal kanë përgjegjësi të modelojnë praktikën e mira, duke marrë pjesë në mësimin profesional të vazhduar. Parimi 7: Të mësuarit profesional është një përgjegjësi individuale dhe kolektive në të gjitha nivelet e sistemit (jo vetëm në nivelin e shkollës) dhe nuk është opsionale.***

Mësimi profesional duhet të zhvillohet në të gjitha nivelet e sistemit. Është përgjegjësi individuale dhe kolektive që përfshin shkolla, rajone dhe qendra. Për mësuesit dhe drejtuesit e shkollave mësimi profesional duhet të lidhet me qëllimet e performancave të shkollave. Këto synime nga ana tjetër duhet të reflektojnë nevojat dhe qëllimet e qendrave dhe rajoneve. Mësimi profesional është lidhur në mënyrë të pandashme me rritjen e kapacitetit të sistemit në tërësi.

## Appendix B: Aktivitetet e shkollave efektive

Aktiviteti i mëposhtëm mund të përdoren për të lehtësuar bisedat rreth efektivitetit të shkollës.



Përzgjidhni një faktor. A është një karakteristikë e rëndësishme e një shkolle efektive?

---

---

---

Si do të demonstron ky faktor në praktikë?

---

---

---

Çfarë provash keni parë për këtë në shkollën tuaj?

---

---

---

Cilat praktika duhet të zhvillohen më tej ose të synohen për të vepruar?

---

---

---

# Apendiksi C: Aktivitetet e të mësuarit efektiv profesional

---



Aktiviteti i mëposhtëm mund të përdoren për të lehtësuar bisedat rreth efektivitetit të shkollës.

Përzgjidhni një princip. A është një karakteristikë e rëndësishme në edukimin efektiv profesional?

---

---

Si mund të demonstron në praktikë ky princip?

---

---

Çfarë provash keni parë në shkollën tuaj në lidhje me këtë princip?

---

---

Çfarë praktikash ka nevojë që të zhvillohen më vonë për të vepruar?

---

---